L I G J
Nr.7776, datë 22.12.1993

PËR BUXHETIN LOKAL

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Buxheti lokal është programi kryesor financiar vjetor i pushtetit lokal. Në të përfshihen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e përcaktuara nga ky ligj, në përputhje me kompetencat që ka pushteti lokal në territorin ku vepron.

Çdo komunë, bashki e rreth ka buxhetin e vet. Buxheti lokal është unik dhe përbëhet nga pjesa e buxhetit të pavarur dhe pjesa e buxhetit të kushtëzuar.

Neni 2

Pjesa e buxhetit lokal të pavarur përfshin të ardhurat që me ligj derdhen në buxhetin e komunës, të bashkisë e të rrethit dhe shpenzimet socialekonomike e administrative që janë kompetencë e tyre.

Neni 3

Pjesa e buxhetit lokal të kushtëzuar përfshin pjesën e fondeve të buxhetit qendror që derdhet në buxhetin e komunës, bashkisë e rrethit për t'u përdorur në destinacion të caktuar dhe që vetëm administrohet prej organeve të pushtetit lokal.

Neni 4

Viti buxhetor për buxhetin lokal të pavarur fillon në 1 prill dhe mbaron më 31 mars të çdo viti kalendarik. Viti buxhetor për pjesën e buxhetit lokal të kushtëzuar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo vitit kalendarik.

Neni 5

Klasifikimi i buxhetit lokal në tituj, kapituj e artikuj bëhet nga Ministria e Financave.
Struktura e buxhetit lokal përcaktohet nga Këshilli i komunës, bashkisë dhe rrethit.

Neni 6

Të ardhurat e buxhetit lokal të pavarur formohen nga:
a) Të ardhurat nga burime të brendshme lokale, në të cilat përfshihen :
- të ardhurat nga taksat lokale;
- të ardhurat nga tarifat e shërbimeve;

- të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike në vartësi të pushtetit lokal, shpenzimet e të cilave financohen nga buxheti;
- të ardhurat nga gjobat në zbatim të kompetencave të organeve të pushtetit lokal;
- të ardhurat nga interesat aktive.
- çdo e ardhur tjetër e përcaktuar me ligj.

b) Të ardhurat nga buxheti qendror, në të cilat përfshihen:
- financimi nga buxheti qendror;
- të ardhurat nga pjesa e taksave dhe e tatimeve nacionale që me ligj derdhen drejtpërdrejt në buxhetin lokal.

c) Të ardhurat nga ndihmat dhe kreditë, në të cilat përfshihen:
- të ardhurat nga ndihmat e organizatave humanitare dhe ato që rrjedhin nga marrëdhëniet që vendosen ndërmjet organeve të pushtetit lokal dhe homologëve të tyre në shtete të ndryshme;
- kreditë vetëm për investime në përputhje me dispozitat ligjore;
- të ardhura nga dhurime dhe sponsorizime të ndryshme.

Neni 7

Në shpenzimet e buxhetit lokal të pavarur përfshihen:
- Shpenzime për realizimin e funksioneve administrtive dhe shërbimeve publike lokale;
- shpenzime për investime;
- shpenzime për shërbimin e kësteve të kredisë dhe interesave pasive;
- krijimi i fondit rezervë.

Neni 8

Organi i pushtetit lokal ka të drejtë të parashikojë në buxhetin e tij fond rezervë në masën që e gjykon ai vetë, brenda kufinjve 2-5 për qind të shumës totale të shpenzimeve të miratuara. Ky fond rezervë përdoret për përballimin e shpenzimeve buxhetore të paparashikuara dhe të shpenzimeve për fatkeqësitë nga shkaqe madhore. Të drejtën për të përdorur fondin rezervë në komunë, bashki e rreth e ka këshilli përkatës.

Neni 9

Buxheti lokal nuk parashikohet me deficit. Ai është i balancuar.

KREU II
HARTIMI DHE MIRATIMI I BUXHETIT LOKAL

Neni 10

Projektbuxheti lokal hartohet nga çdo komunë, bashki e rreth dhe miratohet nga këshilli përkatës.

Neni 11

Projektbuxheti për çdo komunë, bashki e rreth, paraqitet në Ministrinë e Financave.

Ministria e Financave i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave dhe ky i fundit Kuvendit Popullor, në përbërje të projektit për buxhetin qendror, vetëm pjesën e financimit nga buxheti qendror për buxhetin e pavarur lokal të çdo komune, bashkie e rrethi.

Pas miratimit të buxhetit qendror nga Kuvendi Popullor, pjesa e financimit të buxhetit qendror për buxhetin lokal i dërgohet çdo komune, bashkie e rrethi, brenda datës 15 dhjetor.

Këshillat e rretheve, bashkive e komunave, miratojnë buxhetin e tyre brenda datës 15 mars. Një kopje e buxhetit të miratuar depozitohet në prefekturë.

Neni 12

Nëse deri në fund të vitit buxhetor këshilli përkatës nuk miraton buxhetin lokal të pavarur, me fillimin e vitit të ri buxhetor vazhdojnë të përdoren për çdo muaj të ardhurat dhe shpenzimet në masën sa 1/12 e treguesve të miratuar në vitin e mëparshëm buxhetor.

Neni 13

Ministria e Financave përgatit udhëzime dhe akte të tjera nënligjore, të nevojshme për hartimin e projektbuxhetit lokal dhe udhëheq procesin e hartimit të këtij buxheti.

KREU III
ZBATIMI I BUXHETIT LOKAL

Neni 14

Zbatimi i buxhetit lokal kryhet nga organet financiare të pushtetit lokal.

Neni 15

Urdhëruesit kryesorë të fondeve buxhetore lokale të pavarura janë:

Për komunën - kryetari i komunës; për bashkinë - kryetari i bashkisë; për rrethin - kryetari i këshillit të rrethit ose personat e autorizuar prej tyre.

Urdhërues të shkallës së dytë e të tretë janë, sipas rastit, drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve publike lokale.

Urdhëruesit për fondet buxhetore lokale të kushtëzuara përcaktohen në ligjin nr.7616,datë 30.9.1992, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë".

Neni 16

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e buxheteve të komunave ,bashkive e rretheve regjistrohen në zyrat e thesarit dhe kontrollohen sipas procedurave të caktuara nga Drejtoria e Thesarit.

Shërbimi i arkës për buxhetin lokal kryhet nga Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë dhe nga çdo bankë tjetër e autorizuar nga Drejtoria e Thesarit.

Neni 17

Kontrolli i të ardhurave dhe i shpenzimeve të buxhetit të pavarur dhe të kushtëzuar në komuna, bashki e rrethe, kryhet rregullisht jo më pak se një herë në vit nga organi i specializuar i tyre dhe nga komisioni përkatës i kontrollit të këshillit të komunës, bashkisë e rrethit.

Kontrolle kryhen edhe nga organet e tjera të përcaktuara me ligj, si Shërbimi i Kontrollit të Shtetit, Ministria e Financave dhe prefekturat.

Neni 18

Ndryshimet gjatë zbatimit të buxhetit të pavarur lokal (transferime, rishpërndarje fondesh) bëhen nga këshillat përkatës, në bazë të procedurave të përcaktuara në udhëzimet e Këshillit të Ministrave për zbatimin e buxhetit.

Neni 19

Këshilli i komunës, bashkisë dhe rrethit është i vetmi organ që ka të drejtë të transferojë fondet falas ose me të drejtë kthimi, për t'ia kaluar organeve homologe, nga të ardhurat nga burimet e brendshme të buxhetit të pavarur lokal.

Neni 20

Ministria e Financave , kur lind nevoja gjatë vitit, mund të transferojë fondet e buxhetit qendror (që bëjnë pjesë në buxhetin e pavarur të një komune, bashkie e rrethi) në një komunë, bashki a rreth tjetër vetëm me miratimin e këshillit që disponon fondet.

Neni 21

Nëse të ardhurat nga burimet lokale ose çdo e ardhur tjetër, duke përfshirë edhe ato të buxheti qëndror, janë më të larta se ato të parashikuara në buxhet, atëherë këshilli përkatës mund t'i rritë shpenzimet në buxhetin lokal të pavarur.

Nëse të ardhurat nga burime të brendshme lokale ose të ardhura të tjera janë më të ulëta se ato të parshikuara në buxhet, atëherë shpenzimet duhet të pakësohen në të njëjtën masë. Shtesa e fondeve nga buxheti qendror bëhet vetëm me miratim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Kur me mbylljen e vitit buxhetor krijohet tepricë fondesh buxhetore nga burime të brendshme lokale kjo mbartet si e tillë në vitin e ardhshëm buxhetor. Fondet e buxhetit qendror, të papërdorura në fund të vitit nga organet e pushtetit lokal, kalojnë në favor të buxhetit qendror.

Neni 23

Çdo urdhërues buxhetor detyrohet të marrë masat e nevojshme që sigurojnë plotësimin e buxhetit sipas strukturave dhe klasifikimit buxhetor. Periodikisht dhe në fund të vitit urdhëruesit kryesorë i raportojnë organeve të zgjedhura për plotësimin e buxhetit të tyre përkatësisht në komunë, bashki e rreth. Ata i raportojnë gjithashtu prefekturës dhe Ministrisë së Financave për fondet e dhëna nga buxheti qendror.

Neni 24

Punonjësit e ngarkuar për raportimin e buxhetit në Ministrinë e Financave dhe prefekturave mbajnë përgjegjësi për respektimin e afateve të caktuara nga ky ligj dhe aktet përkatëse nënligjore.

Shkelja e këtij rregulli përbën kundërvajtje administrative që dënohet nga drejtori i buxhetit i Ministrisë së Financave me gjobë nga 1000 deri në 5000 lekë.

Neni 25

Këshilli i komunës, bashkisë e rrethit, pasi shqyrton zbatimin e buxhetit të tij, miraton buxhetin faktik të pavarur dhe të kushtëzuar të vitit të mëparshëm dhe brenda muajit gusht të çdo vitit e depoziton pranë prefekturës dhe Ministrisë së Financave.

Neni 26

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 27

Dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.7616 , datë 30.9.1992, "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.266, datë 22.7.1992 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë"", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 28

Zbatimi i procedurave sipas këtij ligji fillon gjatë vitit 1994. Procedurat e parashikuara në këtë ligj përjashtohen për vitin 1993.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.746, datë 6.1.1994 të Presidentit tëRepublikës së Shqipërisë, Sali Berisha.